



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 12, datë 08.07.2016

PËR

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1, DATË 30.07.2015 “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE QË DO TË NDIQEN NGA AUTORITETET E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR LEJE NDËRTIMI DERI NË MIRATIMIN E PLANEVE TË PËRGJITHSHME VENDORE”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, dhe Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit

VENDOSI:


1. Në Vendimin Nr. 1, datë 30.07.2015 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga Autoritetet e Zhvillimit të Territorit për shqyrtimin e kërkesave për Leje Ndërtimi deri në miratimin e Planeve të Përgjithshme Vendore”, i ndryshuar, bëhen ndryshimet si vijon:
 - a) Në pikën 2, gërma “a”, zëvendësohet me fjalinë si më poshtë:
“punime mirëmbajtje dhe të infrastrukturës publike;”
 - b) Në pikën 2, gërma “g”, zëvendësohet me fjalinë si më poshtë:
“shtesa në komplekse rezidenciale me “vila individuale”, deri në masën 50 % të sipërfaqes totale të ndërtimit, duke respektuar kushtet urbane sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar.”
 - c) Pika 3 zëvendësohet me fjalinë si më poshtë:
Autoritetet e zhvillimit të territorit lejohet të japin leje ndërtimi, për rastet përjashtimore të pikës 2, vetëm brenda zonave të urbanizuara, të identifikuara sipas vendimit nr. 5, datë 29.12.2014 të Këshillit Kombëtar të Territorit, me përjashtim të:
 - a) *punimeve të infrastrukturës sipas gërmës “a”;*
 - b) *strukturave sipas gërmës “d”;*
 - c) *strukturave të gërmës “e”, për të cilat zbatohet VKM nr. 283, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve*

për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore”, e ndryshuar;
d) *banesave një familjare sipas gërmës “ë”;*

për të cilat pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave për leje ndërtimi kryhet edhe jashtë zonave të urbanizuara, me kushtin që para miratimit të lejes së ndërtimit të kryhet konvertimi përkatës në rësurs toke “truall”, sipas procedurave përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

d) Pika 3/1 shfuqizohet.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



ZËVENDËS KRYETAR I KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



SEKRETARI KKT

LEDIA TOTA

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

